

Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Beratit





Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Beratit

Plani i Zhvillimit të Komunitetit rom dhe egjiptian në Bashkinë e Beratit (2017-2020) u mundësua në kuadër të Projektit “Fuqizimi Ekonomik dhe Social i Romëve dhe Egjiptianëve – një shtysë për përfshirje sociale” (FESRE), financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) në Shqipëri. Procesi planifikues u asistua nga ekspertët e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në bashkëpunim me Grupin Lokal me pjesëmarrje të krijuar në Bashkinë e Beratit përgjatë muajve Dhjetor 2016 -Shtator 2017.

Grupi i ekspertëve të IDM-së:

Evelina Azizaj
Shefqet Bruka
Armela Xhaho

Ekspertët Lokal

Klaudja Hamiti
Leonard Avdiu

Kryetar i Grupit Lokal të Planit të Zhvillimit të Komuniteteve rome dhe egjiptian

Teuta Muçogllava - Nënkryetare, Bashkia Berat

Publikimi i këtij materiali u mundësua me mbështetjen financiare të projektit “Fuqizim Ekonomik dhe Social për Romët dhe Egjiptianët – shtysë për përfshirjen sociale”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Pikëpamjet e shprehura në këtë material nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pozicionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose agjensive të saj.

**Grupi Lokal me Pjesëmarrje për hartimin
e Planit të Zhvillimit të Komunitetit rom dhe egjiptian**

Emër/Mbiemër	Institucioni	Pozicioni i punës	Email
Teuta Mucogllava	Bashkia Berat	N/Kryetare	teutamucogllava@gmail.com
Vjollca Hoxha	Bashkia Berat	Drejtoare e Shërbimeve Sociale	vjollcahoxha.ad@gmail.com
Sadete Myftari	Bashkia Berat	Drejtoare e Shërbimeve Sociale	myftarisadete@info.al
Nadire Rënja	Këshilli i Bashkisë Berat	Këshilltare	nadireronja@outlook.com
Mirela Buhuri	DRSHSSH	Drejtoare	mbuhuri@yahoo.it
Alma Laska	Drejtoria Rajonale e Punësimit	Specialiste e Nxitjes së Punësimit	almalasha@gmail.com
Borjana Sofia	Njësia Ad. Otlak	Specialiste e Ndhmës Ekonomike	borjanasofia10@gmail.com
Erka Durra	Bashkia Berat	Drejtoria e Arsimit	erkadurra11@gmail.com
Lumturi Dyrmishi	Bashkia Berat	Drejtoria e Gjendjes Civile	lumedyrmishi@gmail.com
Meleqe Spahiu	Bashkia Berat	Drejtoria e Strehimit	meleqespahiu@yahoo.com
Piro Xheblati	Bashkia Berat	Përgjegjës Sektori Ndhima ekonomike	piroxheblati@hotmail.com
Viola Spahiu	DRFSDKSH	Specialiste	spahiu.viola@gmail.com
Valbona Qafa	DVP	Juriste	valbona.qafa@asp.gov.al
Albana Shyti	Bashkia Berat	Specialiste e buxhetit	ashyti31@yahoo.com
Brunilda Zonja			
Ariana Hodaj	DRSH	Specialiste e Burimeve Njerëzore	ariana@shqiptar.eu
Alime Avdiu	Amaro - Drom	Koordinatorë	
Endrit Myrteli	Morave	Komuniteti	geroldote10g2@gmail.com
Ervisa Alimi	DRSH SSH	Punonjëse Sociale	ervisa.alimi@gmail.com
Rexhina Limja	Bashkia Berat	Specialiste Qendra Rinore	rexhinalimja@yahoo.com
Brunilda Zonja	Bashkia Berat	Punonjëse Sociale	brunacipi@yahoo.com
Betina Kadena	Qendra Komunitare	Stomatologe	kadenabetina@yahoo.com
Esmerald Eski	Bashkia Berat	Specialiste e strehimit	esmerald.eski@gmail.com
Artan Diko	Media Klan	Gazetar	artandiko@gmail.com
Robert Nazari	ESERE	Koordinator	
Leonard Avdiu	IDM Albania	Ekspert Lokal	leonardavdiu2017@gmail.com
Klaudja Hamiti	IDM Albania	Ekspert Lokal	kludiahamiti@yahoo.com
Kastriot Dulla	Përfaqësues Komuniteti	Mediator Punësimi	kastriotdulla3@gmail.com
Besmir Dalipi	Përfaqësues Komuniteti	Lehtësues	beso.dalipi@gmail.com

Tabela e përmbajtjes

SHKURTIME	8
HYRJE	11
<hr/>	
KAPITULLI I. QASJA METODOLOGJIKE	16
Parimet udhëzuese të planit të zhvillimit të komuniteteve rome dhe egjiptiane	18
Metodologjia	22
Aktorët e përfshirë?	22
<hr/>	
KAPITULLI II. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE	25
Komuniteti rom dhe egjiptian në Bashkinë e Beratit	26
Regjistrimi civil dhe aksesimi në sistemin e drejtësisë	30
Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor	34
Kujdesi shëndetësor	42
Punësimi, arsimi dhe formimi profesional (AFP)	47
Strehimi dhe integrimi urban	53
Mbrojtja sociale	62

KAPITULLI III. PLANI I VEPRIMIT **69**

Deklarata e vizionit 69

Qëllimet strategjike dhe objektivat specifik 70

Fusha prioritare: Regjistrimi Civil dhe Aksesit në Sistemin e Drejtësisë 71

Fusha prioritare: Arsimit dhe Promovimit i dialogut ndërkulturor 77

Fusha prioritare: Kujdesi shëndetësor 78

Fusha prioritare: Punësimi, arsimi dhe formimi profesional (AFP) 81

Fusha prioritare: Strehimi dhe integrimi urban 84

Fusha prioritare: Mbrojtja sociale 90

KAPITULLI IV. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT **93**

ANEKSE **101**

Aneks 1. 102

Aneks 2. Panoramë e përgjithshme e kuadrit ligjor, politikave dhe strategjive për integrimin social dhe ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian 102

Shkurtime

ASHR	Autoriteti Shëndetësor Rajonal
BE	Bashkimi Europian
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
DRSH	Drejtoria Rajonale e Shëndetit
DSHP	Drejtoria e Shëndetit Publik
DSHS	Drejtoria e Shërbimeve Sociale
FESRE	Fuqizimi Ekonomik dhe Social i Romëve dhe Egjiptianëve
GMV	Grupi i Monitorimit dhe Vlerësimit
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
IRCA	Instituti i Kulturës Rome
NE	Ndihma Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
NJMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës
PAK	Persona me Aftëzi të Kufizuar
PNUD	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
PZHK	Plani i Zhvillimit të Komunitetit
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
ZRP	Zyra Rajonale e Punësimit

Fjala e Kryetarit të Bashkisë

Plani lokal për zhvillimin e komuniteteve rome dhe egjiptiane në Bashkinë e Beratit (2017-2020) është një plan që targeton dy komunitetet përkatëse dhe paraqet në mënyrë të detajuar masat që do të zbatohen në politikat e Bashkisë dhe qeverisjes qendrore për nxitjen dhe integrimin e komuniteteve rome dhe egjiptiane.

Ky plan është i mbështetur në strategjinë e zhvillimit të qytetit, por edhe në strategjitë kombëtare për zhvillim dhe integrim. Ai është një rishikim i planit të mëparshëm të zhvillimit të romëve dhe egjiptianëve, sepse Bashkia Berat ka pasur një plan të hartuar qysh më parë, por zbatimi i reformës territoriale solli nevojën e rishikimit të tij, pasi fusha e veprimit dhe përfshirjes është më e madhe. Procesi i hartimit ka marrë kohën dhe vëmendjen e duhur nga administrata e bashkisë dhe grupi lokal i ngritur për këtë qëllim.

Një falenderim për punën e bërë shkon edhe për donatorët që financuan këtë plan, si: FESRE, PNUD dhe Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim për ekspertizën e ofruar.

Petrit Sinaj

Kryetar i Bashkisë Berat

HYRJE



Plani për Zhvillimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian është një instrument demokratik planifikimi dhe menaxhimi që synon të adresojë në terma afatshkurtër sfidat me të cilat përballen dy komunitetet, duke synuar në arritjen e një vizioni që lidhet me një shkallë më të madhe të integritit të anëtarëve të këtyre komuniteteve në jetën sociale dhe ekonomike në nivel lokal.

Ky plan shërben si një mekanizëm orientues të veprimeve që aktorët vendorë dhe rajonal duhet të ndërmarrin për të adresuar sfidat dhe barrierat që pengojnë dy komunitetet në sigurimin e një jete dinjitoze. Dokumenti i planit fillimisht jep një pasqyrë të situatës aktuale të komunitetit Rom dhe Egjiptian lidhur me gjashtë sfidat kryesore (ku jemi aktualisht në lidhje me: a) regjistrimin civil dhe aksesin në drejtësi; b) arsimimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor; c) kujdesin shëndetësor; d) punësimin, formimin dhe edukimin profesional; e) strehimin dhe integrimin urban, si dhe f) mbrojtjen sociale).

Pas analizës së situatës aktuale, plani propozon vizionin për zhvillimin e dy komuniteteve (se si duam ta shohim komunitetin Rom dhe Egjiptian pas 7-10 vitesh) dhe cili është itinerari për të arritur aty ku dëshirojmë në të ardhmen, ose me fjalë tjera, plani i veprimit që adreson sfidat sipas gjashtë fushave prioritare. Plani i veprimit paraqet qëllimet strategjike dhe objektivat specike për gjashtë fushat, ndërsa çdo objektiv ka të renditura projektet dhe hapat e veprimit konkret, të cilat janë të detajuara në lidhje me ndarjen e përgjegjësisive ndërmjet aktorëve lokalë dhe rajonalë, implikimet financiare, burimet e të ardhurave, si dhe treguesit e performancës dhe afatet kohore. Zbatimi i hapave të veprimit në përputhje me afatet kohore dhe treguesit e synuar duhet të monitorohet dhe të raportohet.

PZHK është një instrument praktik dhe relativisht i thjeshtë për t'u përdorur jo vetëm nga aktorët publikë (administrata lokale e bashkisë dhe e institucioneve të tjera vendore të dekoncentruara si Drejtoria Arsimore rajonale, Fondi Shëndetësor, Insituti i Shendetit Publik, policia, etj), por edhe nga aktorët e shoqërisë civile, grupet e ndryshme sociale, në kontributin e tyre për adresimin e sfidave sipas veprimeve të parashikuara në Plan, duke bërë të realizueshëm edhe vizionin e artikuluar në dokument. Koordinimi i përpjekjeve ndërmjet aktorëve lokal për zbatimin e këtij plani është tejet i rëndësishëm

Plani i Zhvillimit të Komuniteteve rome dhe egjiptian në bashkinë e Beratit fokusohet në trajtimin e gjashtë sfidave të identifikuara edhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, por të lidhura ngushtë me kontekstin vendor

duke marrë në konsideratë faktin që një dokument i tillë reflekton nevojat dhe preferencat e anëtarëve të dy komuniteteve dhe të aktorëve të tjerë lokalë. Procesi planifikues ka siguruar hapësirë që anëtarët e dy komuniteteve të kenë një zë në vendimet që ndikojnë zhvillimin e tyre dhe se ndërhyrjet për zhvillim janë të përshtatshme me nevojat dhe preferencat e tyre. Procesi i hartimit të planit ka patur natyrë të lartë pjesëmarrëse dhe gjithëpërfshirëse dhe dokumenti final është rezultat i konsultimeve të gjera me aktorë publikë dhe jopublikë që veprojnë në sektorë të ndryshëm.

Pikërisht identifikimi i (dis)avantazheve të vazhdueshme që përballen këto komunitet dhe orientimi i politikave vendore në funksion të përfshirjes dhe zhvillimit socio-ekonomik të komuniteteve vulnerabël kërkon një ndërhyrje efektive multisektorale dhe shumaktoriale në nivel vendor. Nje plan strategjik është jo vetëm një parakusht për të mobilizuar burime të tjera financimi dhe akses në fonde nga donatorë të ndryshëm, por edhe një tregues tepër i rëndësishëm në përpjekjen për të rritur mirëqenien, integrimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për këto grupe në nevojë. E thënë ndryshe, politikatat në nivel vendor të orientuara drejt përfshirjes sociale kanë një efekt pozitiv jo vetëm në adresimin e nevojave dhe sfidave që përballen këto komunitete, por edhe më tej në integrimin

Qëllimi kryesor i procesit planifikues është t'u japë grupeve vulnerabël si Rom dhe Egjiptianë një mjet që fuqizon në mënyrë të veçantë grupet në nevojë, duke i bërë ato pjesëmarrëse direkte në vendimmarrje, nëpërmjet dizenjimit të aktivitete konkrete të planit të veprimit për zhvillim nga vetë ata. Kjo bëhet më domethënëse kur planifikimi i zhvillimit synon specifikisht grupet në nevojë, si komunitetet Rome dhe Egjiptiane, të cilët jetojnë në kushte të vështira socio-ekonomike dhe janë të përjashtuar nga proceset vendimmarrëse që ndikojnë jetët e tyre, por konkretisht edhe nga një sërë shërbimesh publike.

e qëndrueshëm në fushat prioritare, si: punësimi, arsimimi, strehimi, mbrojtja sociale, shëndetësia.

Plani i Zhvillimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë e Beratit fokusohet në trajtimin e gjashtë sfidave të identifikuara edhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, por të lidhura ngushtë me kontekstin vendor. Ky plan zhvillimi është hartuar me synimin që të shërbejë si instrument për orientimin e përpjekjeve ndërsektoriale dhe shumaktorëshe në lidhje me integrimin social ekonomik të dy komuniteteve në bashkinë e Beratit. Njohja e mirë e potencialeve dhe sfidave me të cilat përballen dy komunitetet në 6 fushat prioritare: regjistrimi civil dhe aksesimi në drejtësi, arsimimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor, kujdesi shëndetësor, punësimi dhe formimi profesional, strehimi dhe integrimi urban si dhe mbrojtja sociale, arrin të mbulojë dhe adresojë gamën e gjerë të probematikave shumedimensionale të dy komuniteteve.

Ky dokument është i organizuar në katër kapituj kryesor. Në kapitullin e parë përshkruhet qasja metodologjike e procesit planifikues të këtij dokumenti, parimet e planit, modeli konceptual i procesit planifikues sipas fazave, instrumentet e përdorura, duke vënë theksin edhe te aktorët e përfshirë në këtë proces. Në kapitullin e dytë paraqitet situata aktuale e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Beratit sipas gjashtë fushave prioritare të përmendura më sipër. Kapitulli i tretë paraqet deklaratën e Vizionit dhe qëllimet strategjike të planit, i cili vijon me kapitullin e matricës së planit të veprimit, që përfshin qëllimet strategjike, objektivat specifike, aktivitetet sipas fushave prioritare. Në kapitullin e fundit, rëndësi të vecantë i kushtohet monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të planit, pasi është tejet e nevojshme dhe e rëndësishme ndjekja e zbatimit të strategjisë për të vlerësuar rezultatet e pritura të objektivave strategjike.

KAPITULLI 1

QASJA METODOLOGJIKE



Në thelb të të gjitha nismave në nivel lokal, që synojnë integrimin e anëtarëve të komuniteteve rome dhe egjiptiane duhet të mbeten të gjitha parimet e mëposhtme, duke vënë theksin në qasjen ndërsektoriale dhe shumaktorëshe që ato kërkojnë

Parimet udhëzuese të planit të zhvillimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane

Në thelb të të gjitha nismave në nivel lokal, që synojnë integrimin e anëtarëve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane duhet të mbeten të gjitha parimet e mëposhtme, duke vënë theksin në qasjen ndërsektoriale dhe shumaktorëshe që ato kërkojnë. Si pasojë e nevojës së kësaj qasje, ajo çfarë është emergjente dhe realiteti i aktorëve vendor në Shqipëri kërkon forcimin dhe koordinimit mes institucioneve në nivel lokal dhe qendror ne partneritet me sektorin jopublik.

1. Nxitja e përfshirjes sociale

Planit i Zhvillimit të Komunitetit i kushton një vëmëndje të veçantë nxitjes së përfshirjes sociale të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane. Përpos masave të qeverisë shqiptare për integrimin e këtij komuniteti në shoqëri, në përgjithësi ekziston një frymë përjashtuese dhe marginalizuese duke i bërë këto grupe vulnerabël. Plani orientohet veçanërisht në përpjekjet për të rritur aksesin e romëve dhe egjiptianëve në punësimin formal, në të gjitha nivelet e sistemit arsimor si edhe në programet e mbrojtjes sociale, në kujdesin shëndetësor, në aksesin në drejtësi, strehim me qëllim rritjen e mirëqënies së këtij komuniteti dhe të integrimin në jetën sociale dhe ekonomike në komunitetet lokale. Plani promovon parimin e përfshirjes sociale duke i përfshirë vetë anëtarët e grupeve vulnerabël në procesin e planifikimit strategjik.

2. Respektimi i dallimeve

Planit i Zhvillimit të Komunitetit respekton dallimet që ekzistojnë ndërmjet komunitetit Rom dhe atij Egjiptian në fushat e ndryshme prioritare. Po ashtu, plani bën dallim edhe midis diferencave që ekzistojnë brenda vetë

nëngrupeve të këtyre komuniteteve, duke mos homogjenizuar grupin/komunitetin si një të tërë. Integrimi i dy komuniteteve vazhdon të jetë ende një sfidë në vazhdimësi, e megjithatë plani njih faktin se disa nëngrupe janë tashmë më të integruara në shoqëri.

3. Qasje ndërsektoriale

Plani i Zhvillimit të Komunitetit vë theksin në nevojën e një qasje ndërsektoriale dhe shumaktorëshe, që përpjekjet për integrimin e dy komuniteteve të sjellin vërtet rezultate. Integrimi në jetën sociale dhe ekonomike të romëve dhe egjiptianëve është i mundur në adresimin e barrierave të përfshirjes sociale në mënyrë të integruar, pra njëkohësisht në shumë prej sektorëve, si: arsimimi, shëndetësia, strehimi dhe integrimi urban, punësimi dhe arsimit e aftësimin profesional, mbrojtja sociale, regjistrimin civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë, duke promovuar zhvillimin dhe integrimin në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme përmes ndërhyrjeve ndërsektoriale. Zbatimi i planit thekson rëndësinë që merr koordinimi i aktorëve lokal publikë dhe jopublikë.

4. Dimensoni i integritit gjinor

Plani i Zhvillimit të Komunitetit nënvizon rëndësinë e integritit të dimensionit gjinor në të gjitha hapat dhe proceset e ndërmarra në këtë kuadër. Integrimi gjinor në terma konkret përkthehet në të dhënat e disagreguara sipas gjinisë dhe në po të njëjtën kohë hartimin e objektivave duke patur parasysh pasojat e tyre për të dyja gjinitë. Për më tepër, plani pranon faktin se gratë romë dhe egjiptiane kanë më shumë gjasa të ndihen të diskriminuara dhe përjashtuara. Kjo, së pari, për shkak të racës dhe së dyti për shkak të gjinisë. Gratë në përgjithësi kanë një qasje më të kufizuar ndaj burimeve ekonomike dhe të vendimmarrjes, shpesh për shkak të mentalitetit dhe praktikave tradicionale të

cilat kontribuojnë në pabarazitë dhe përjashtimin e tyre të vazhdueshëm nga jeta sociale dhe shoqërore. Veprimet e planit kanë një ndjeshmëri gjinore dhe promovojnë arritjen e parimit të barazisë gjinore. Ulja e hendekut të pabarazive midis grave dhe burrave është një element tepër i rëndësishëm i qeverisjes së mirë dhe pritshmërive që BE parashtron ndaj çdo vendi kandidat në lidhje me integrimin gjinor.

5. Parimi i Pjesëmarrjes aktive

Angazhimi konstruktiv i aktorëve lokalë dhe vetë komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në të gjitha hapat e PZHK-së siguron një model të qëndrueshëm të vendimmarrjes pjesëmarrëse dhe efektive. Procesi i hartimit të planit është në funksion të gjithëpërfshirjes, ku në mënyrë të veçantë anëtarët e dy komuniteteve ndihen të përfaqësuar përmes anëtarëve të vetë komunitetit në grupin e punës. Procedurat e ndjekuara në hartimin e planit sigurojnë gjithashtu një model transparent të demokracisë pjesëmarrëse, ku vetë komuniteti ndihet i mirëdëgjuar përsa i përket vendimeve të cilat do të influencojnë dhe ndikojnë padyshim në vetë cilësinë dhe mirëqënien e jetës së tyre.

6. Barazia para ligjit dhe parimi i mosdiskriminimit

Të gjitha aktivitetet e planifikuara në kuadër të Planit të Veprimit do të kenë në qendër të vëmendjes së tyre respektimin e të drejtave dhe garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit para ligjit. Parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit qëndrojnë në themel të Kushtetës së Shqipërisë (neni 18) si edhe në Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut, të vitit 1948 (nenin 2). Sipas këtij parimi, çdo individ gëzon të drejtat dhe liritë e përcaktuara pa asnjë kufizim përsa i përket gjinisë, racës, gjuhës, përkatësisë fetare, mendimit politik, origjinës kombëtare e shoqërore, pasurisë, përkatësisë në një minoritet kombëtar, lindjes ose çdo status tjetër social ekonomik apo arsimor.

Modeli konceptual: Hartimi i planit të zhvillimit të komunitetit

Faza përgatitore

Vlerësimi i komunitetit

HAPI 1: Identifikimi i aktorëve

HAPI 2: Garantimi i angazhimit politik

HAPI 3: Ofrimi i mbështetjes teknike dhe ngritja e grupeve të punës dhe nën-grupeve të punës

HAPI 4: Mbledhja e informacionit

HAPI 5: Mobilizimi i komunitetit

HAPI 6 - Të dhënat: Fushat prioritare të planit

- 1- Regjistrimi civil dhe aksesimi në drejtësi
- 2- Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor
- 3- Punësimi, arsimi dhe formimi profesional
- 4- Kujdesi shëndetësor
- 5- Strehimi dhe integrimi urban
- 6- Mbrojtja sociale

HAPI 8:

Analiza,
sintetizimi i të
dhënave

HAPI 7:

Pema e
problemeve

SWOT

HAPI 9:

Ofrimi i asistencës

- 1- Vizioni
- 2- Qëllimi strategjik
- 3- Objektivat specifik

HAPI 10:

Pema e objektivave

HAPI 11:

Aktivitetet
Institucionet
Periudha kohore
Burimi i financimit
Indikatorit
Treguesi bazë
Treguesi i synuar 2020
Burimi i të dhënave

HAPI 16:

Monitorim dhe vlerësim

HAPI 15:

Zbatimi i planit

HAPI 13:

Finalizimi i planit

HAPI 14:

Aprovimi i dokumentit
në këshill

HAPI 12:

Konsultimi me
aktoret e interesit
& publikun



Metodologjia

Për hartimin e Planit të Zhvillimit është përdorur një kombinim i metodologjisë kërkimore sasiore dhe cilësore duke u bazuar edhe në të dhënat parësore dhe dytësore nga institucionet respektive në Bashkinë e Beratit. Metodologjia kërkimore përfshin: 1) Intervista gjysmë të strukturuar ballë për ballë me anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian; 2) Intervista të thelluara me informantë kyç nga institucionet vendore dhe shoqëria civile; 3) fokus grupe me banorë të komuniteteve; 4) sesion SWOT me anëtarët e grupit lokal të punës; 4) ëorkshope me grupin e punës duke përfshirë punën në grupe tematike.

Aktorët e përfshirë?

Identifikimi dhe përfshirja e aktorëve kryesorë në zhvillimin lokal është thelbësore për hartimin me sukses të këtij plani zhvillimi. Duke pranuar se çështja e integritit dhe fuqizimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane kërkon një qasje ndërsektoriale, shumaktorëshe dhe gjithëpërfshirëse për vetë kompleksitetin e sfidave dhe problemeve me të cilat përballen, procesi i draftimit dhe konsultimit të planit ka përfshirë aktorë të ndryshëm si nga sektori publik ashtu edhe jopublik. Përfshirja e gjerë e aktorëve përgjatë procesit planifikues është një parakusht i domosdoshëm për të krijuar një model të qëndrueshëm, racional dhe vizionar të planit. Kjo qasje kërkon gjithashtu, një përfshirje edhe më të përgjegjshme në procesin e zbatimit dhe të monitorimit të planit me qëllim që plani të mos jetë thjesht një dokument statik, por të lejojë fleksibilitetin e ndërhyrjeve në koherence me zhvillimet/ ndryshimet aktuale që paraprijnë komunitetin. Pra, vizioni për planin është më shumë se një produkt, pasi ai reflekton një qasje më dinamike të mekanizmave institucionale në nivel vendor për të adresuar / rishikuar me fleksibilitet nevojat në zhvillim.

Grupi lokal me pjesëmarrje i planit të zhvillimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane propozohet të ketë përbërjen si më poshtë:

Grupi Lokal me pjesëmarrje të PZHK

Këshilli bashkiak & Njesitë vendore

- Të zgjedhurit lokal
- 3-4 anëtarë të Këshillit Bashkiak
- 3-5 administratorë të Njësive Administrative

Stafi kyç i Bashkisë

- Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit
- Drejtoria e financave & buxhetit
- Drejtoria shërbimeve sociale
- Njësia e mbrojtjes së fëmijëve
- Ndhima ekonomike
- Gjendja civile

Përfaqësues të autoriteteve të tjera publike

- Zyra Rajonale e Punësimit
- Zyra Rajonale e Shërbimit Social
- Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik
- Drejtoria Arsimore Rajonale
- Drejtoria e Policisë

Shoqëria civile & Komuniteti

- 3-5 anëtarë të forumeve të këshillimit të komunitetit
- Përfaqësues nga organizata lokale të shoqërisë civile
- Aktivistë

KAPITULLI 2

ANALIZA E SITUATËS AKTUALE



Në Bashkinë e Beratit jetojnë aktualisht më shumë se 12,000 banorë të komunitetit Egjiptian dhe afërsisht 1,500 banorë të komunitetit Rom. Pjesëtarët e dy komuniteteve përfaqësojnë 13,7% të popullsisë totale të bashkisë, një përqindje kjo e konsiderueshme

Komuniteti Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Beratit

Në Bashkinë e Beratit jetojnë aktualisht më shumë se 12,000 banorë të komunitetit Egjiptian dhe afërsisht 1,500 banorë të komunitetit Rom¹. Pjesëtarët e dy komuniteteve përfaqësojnë 13,7% të popullsisë totale të bashkisë, një përqindje kjo e konsiderueshme.

Sic shihet, komuniteti Egjiptian është rreth 11 herë më shumë se ai rom, duke përbërë 12,3 % të popullsisë totale të bashkisë, në një kohë kur komuniteti Rom veç 1,5%. Megjithatë, numri i banorëve të komunitetit Rom mendohet të jetë më i madh bazuar në të dhënat që ofrojnë organizatat e shoqërisë civile, të cilat raportojnë më shumë se ç'tregojnë të dhënat zyrtare.

Më poshtë paraqiten të dhënat demografike të popullsisë së bashkisë dhe komuniteteve rome dhe egjiptiane.

Njësitë administrative (NJA)	Popullsia e Bashkisë		Popullsia rome		Popullsia egjiptiane	
	Nr. i banorëve	Nr. familjeve	Nr. i banorëve	Nr. familjeve	Nr. i banorëve	Nr. familjeve
Lagjia Nr 1	21,541	7501	6	1	3,800	1,052
Lagjia Nr 2	21,494	7,573	324	72	3,968	998
Lagjia Nr 3	20,000	6,672	216	57	4,273	1,425
Nj.A Sinjë	5420	1542	0	0	0	0
Nj.A Roshnik	3896	1060	0	0	0	0
Nj.A Otlak	14.699	4148	900	197	103	25
Nj.A Velabisht	12.065	3310	0	0	35	110
Totali	99,115	31,806	1,446	323	12,179	3,610

Burimi: Bashkia Berat 2017

1. Bashkia Berat, 2017

Siç edhe dihet, karakteristikë e dy komuniteteve janë familjet me më shumë anëtarë krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë. Madhësia mesatare e familjes rome² rezulton pothuajse 4.4 anëtarë duke qenë më e lartë se mesatarja e familjes në popullatën e përgjithshme që paraqitet në 3.9 anëtarë³. Edhe në bashkinë e Beratit, raporti nr. banorë/nr.familje është më i lartë për komunitetin Rom (4.5) krahasuar me treguesin për komunitetin Egjiptian (3.4) si dhe me treguesin e gjithë popullatës së bashkisë (3.0)

Popullsia rome dhe egjiptiane është e lokalizuar njëtrajtësisht në tre lagjet e qytetit të Beratit dhe në dy nga njësitë administrative tipike rurale siç është Otlaku dhe Velabishti. Pavarësisht shpërndarjes homogjene në tre lagjet e bashkisë, njihen disa minizona ku dy komunitetet janë të konsiderueshme përsa i përket përqëndrimit të tyre. Këtu do të veçonim si më poshtë:

Lagja "Donika Kastrioti" ka një përqëndrim më të madh të komunitetit Egjiptian dhe më pak të komunitetit Rom. Rreth 520 banorë të komunitetit Egjiptian jetojnë në këtë lagje dhe vetëm 24 banorë të komunitetit Rom.

Në lagjen "Barikadë" janë të lokalizuar kryesisht anëtarë të komunitetit Egjiptian, rreth 480 pjesëtarë të komunitetit Egjiptian jetojnë në këtë lagje.

Ish-pjeshkorja, zonë kryesisht informale, e populluar në 20 vitet e fundit. Rreth 300 banorë të komunitetit Rom kanë ndërtuar banesat e tyre informale, ku nuk mungojnë edhe rastet e familjeve rome që jetojnë ende në çadër.

Njësia Administrative Moravë është një zonë rurale e cila ka një përqëndrim më të madh të komunitetit Rom dhe më pak Egjiptian, rreth 190 familje rome. Në Orizaj dhe Lapardha jetojnë rreth 25 familje rome⁴. Popullsia e

2. Po aty

3. Po aty

4. Instituti i Kulturës Rome (IRCA, 2015)



Banesa të komunitetit rom në fshatin Moravë



Banesa të komunitetit rom në lagjen e Ish-Pjeshkores

këtyre njërive administrative merret kryesisht me bujqësi, që përbën edhe aktivitetin ekonomik kryesor edhe për komunitetin Rom rezident në këtë njësi.

Dhe pse dy komunitetet janë grupi target i këtij plani zhvillimi, duhet pranuar se ka dallime të konsiderueshme ndërmjet tyre në shumë aspekte që lidhen me nivelin e integritimit duke u dalluar në nivelin arsimor, kulturor, kushtet e jetesës etj. Komuniteti Egjiptian reflekton situatë më pozitive në lidhje me integrimin në jetën social ekonomike të bashkisë, nisur edhe nga fakti që është më i përhapur në bashkëjetesën me komunitetin mazhorancë të bashkisë, përkundrajt komunitetit Rom që tenton të jetojë në komunitete më të mëdha rome.



Banesa të komunitetit egjiptian në lagjen "Barrikada"



Banesa të komunitetit në lagjen "Donika Kastrioti"

Pavarësisht dallimeve mes dy komuniteve në lidhje me nivelin e integrit, studimet tregojnë se pjesëtarët e këtyre komunitetëve janë më të varfër se pjesa tjetër e popullsisë. Dy komunitetet karakterizohen nga probleme shumëdimensionale të tilla, si: kushte të vështira dhe të këqija jetese, të adhura tepër të ulëta, papunësi masive dhe përfshirje e lartë në tregun informal të punës etj. Më specifikisht, komuniteti Rom përballet me probleme të regjistrimit civil, frekuentimit të arsimit në të gjitha nivelet (parashkollor, 9-vjeçar, të mesëm dhe të lartë), përfshirjen në tregun formal të punës, kushtet ekstremisht të këqija të jetesës etj. Për dallim, problemet kryesore të komunitetit Egjiptian lidhen më tepër me nivelin e ulët të jetesës si rezultat i të ardhurave të pakta dhe papunësisë së lartë.

Regjistrimi civil dhe aksesimi në sistemin e drejtësisë

Në bashkinë e Beratit, komuniteti Egjiptian është i regjistruar në gjendjen civile pothuajse në masën 100% të popullsisë së vet. Probleme të regjistrimit civil përjetojnë vetëm anëtarët e komunitetit Rom.

Sipas Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF), aktualisht janë rreth 15 raste të fëmijëve të paregjistruar, të cilët kryesisht i përkasin grupmoshës 0-13 vjeç. Në vitet e fundit numri i fëmijëve të paregjistruar ka ardhur duke u reduktuar. Vetëm në gjashtë vitet e fundit, nga 73 fëmijë të paregjistruar, tashmë numërohen 15, të cilat trajtohen si raste nga bashkia Berat duke i referuar në Agjensitë që ofrojnë shërbime ligjore falas për të mundësuar regjistrimin e tyre.

Këto përpjekje kanë qenë të suksesshme falë:

- njohjes së mirë të situatës në lidhje me çështjen e regjistrimit civil nga ana e administratës publike, të tillë si punonjësit e gjendjes civile, punonjësi i NJMF si dhe specialistët e ndihmës ekonomike;
- informimit dhe sensibilizimit të prindërve të komunitetit Rom rreth pasojave që kanë fëmijët dhe familjet nga mungesa e regjistrimit;
- presionit pozitiv të ushtruar nga specialistët e shëndetësisë, arsimit, bashkisë ndaj prindërve për të mos neglizhuar procesin e regjistrimit.

Megjithë përpjekjet dhe rezultatet e arritura në këtë fushë, ende problemi i regjistrimit civil është aktual për një sërë arsyesh, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- Neglizhenca dhe pakujdesia e prindërve për të ndjekur procedurat në momentin e lindjes së fëmijëve;
- Raste të konsiderueshme të fëmijëve të paregjistruar janë edhe fëmijët e lindur nga martesat e re e prindërve pas një ndarje të tyre

nga martesë paraardhëse e cila ende nuk ka përfunduar nga ana e procedurave ligjore; pra, fëmijët të lindur jashtë kurore, por që për shkak të disa procedurave që prindërit duhet të ndjekin, mbeten të paregjistruar;

- Raste të fëmijëve që kanë lindur jashtë vendit, kryesisht në Greqi, ku prindërit kanë dhënë emra të rremë gjë që vështirëson procesin e regjistrimit (në të tilla raste, fëmijët në këto kushte janë regjistruar si fëmijë të gjetur, pa prindër (sipas Udhëzimit të Ministrisë së Brendshme, nr. 7 & Min. Pusht. Vendor). Tri raste numërohen të jenë regjistruar në këto kushte.
- Lindjet e fëmijëve pa asistencën mjekësore (shtëpi, mal, emigracion etj), dhe si rrjedhim nuk vërtetohen me certifikatën e asistencës së lindjes, që hartohet në kohën e lindjes nga personeli mjekësor i pranishëm. Për të regjistruar fëmijët, prindërit duhet t'i drejtohen Gjykatës për të siguruar vërtetimin e faktit të lindjes që do të duhej për regjistrim. Procedura që duhet të ndiqet (sigurimi i dëshmitarit, avokati ose shërbim ligjor falas) për shkak të kohës, ndonjëherë koston dhe të përkushtuarit ndaj ndjekjes së procesit nuk përfundohet nga prindërit e komunitetit rom.

Fëmijët e paregjistruar përballen më një sërë kufizimesh e sfidash që burojnë për shkak të statusit si të paregjistruar ku mund të përmendim: mospajjsja me deftesën e shkollës pas frekuentimit të shkollës; ekspozim i lartë ndaj fenomenit të trafikimit, shfrytëzimit për lypje dhe/ose prostitucion.

Nga pyesori i realizuar në kuadër të procesit planifikues⁵ me familje rome dhe egjiptiane, vetëm 6% shprehen se kanë anëtarë të familjes të paregjistruar.


5. IDM, Pyetësorë me Komunitetin Rom dhe Egjiptian, 2017

Grafiku 1. A janë anëtarët e familjes suaj të regjistruar në gjendjen civile?



Ndërsa të pyetur për numrin e anëtarëve të regjistruar dhe të paregjistruar, nga një total prej 353 anëtarë të familjeve të tyre, vetëm 13 prej tyre janë të paregjistruar, çka përbën 4% të anëtarëve të familjeve të intervistuar. Të pyetur rreth faktorëve që pengojnë regjistrimin civil, të intervistuarit janë shprehur: *“emigrimi / lënia pas dore dhe neglizhenca e vet personave / Nuk di, nuk kam informacion / Nuk kemi certifikaten e lindjes / Prindërit nuk kanë mbushur moshën për martesë/ Burokracia në institucione, etj”*⁶

Grafiku 2. A ka përfituar ndonjë anëtar i familjes suaj ndihmë ligjore falas?



6. IDM, Pyetorë me komunitetin Rom dhe Egjiptian, 2017

Vetëm 17%⁷ e të intervistuarve e shohin regjistrimin civil si problem shqetësues në komunitetin e tyre. Të pyetur nëse ndonjë anëtar i familjes ka përfituar ndihmë ligjore falas, të intervistuarit shprehen në masën 41% nuk kam informacion, 37% e tyre nuk ka kërkuar, ndërsa 20% ka kërkuar por nuk ka marrë dhe vetëm 1% ka marrë ndihmë ligjore.

Për shkak të nivelit të ulët arsimor, nivelit shumë të ulët ekonomik, kompleksitetit të dokumentave dhe procedurave të shumta administrative, anëtarët e dy komuniteteve, kryesisht rome, kanë nevojë për ndihmë juridike dhe administrative për regjistrimin civil dhe të vendbanimit, për legalizimin e banesave, për përfitimin e ndihmës ekonomike, për përfitimin nga programet e strehimit social, programet e punësimit dhe një serë çështjes të tjera.

Ndihma juridike dhe administrative normalisht ofrohet falas nga shërbimi i ndihmës juridike në varësi të Ministrisë Drejtësisë gjë që deri më sot është larg pritshmërive, objektivave dhe treguesve të parashikuar në planveprimin⁸, në të cilin është parashikuar *“krijimi dhe bërja funksionale e klinikave rajonale ligjore për përmirësimin e aksesit ndaj shërbimeve ligjore për romët dhe egjiptianët”* si dhe objektivi *“në fund të vitit 2020, 100% e anëtarëve të komuniteti Rom dhe Egjiptian do të kenë akses të plotë në shërbimin e gjendjes civile”*. Ndërsa ndihma administrative përfshin punonjësit e bashkive dhe institucioneve të tjera lokale të orfojnë ndihmë, kryesisht ofrim informacioni, orientim, këshillim dhe asistim të anëtarëve të komuniteteve në nevojë, kryesisht rreth procedurave administrative, procesit të aplikimit etj

7. Po aty

8. VKM nr.1072, datë 23.12.2015 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve, 2016-2020”

Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor

Arsimimi i komunitetit Rom dhe Egjiptian merr rëndësi tejet të veçantë për faktin se përfaqëson një nga komponentët që thyen barrierat sociale dhe rrit mundësitë e integritimit në jetën shoqërore. Si i tillë, ai duhet parë jo vetëm si një detyrim kushtetues, por si një nga mënyrat më efikase për integrimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian në shoqëri.⁹

Situata aktuale e arsimimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian paraqitet nëpërmjet të dhënave si më poshtë¹⁰:

Arsimi parashkollor ofrohet nga 96 kopshte që përfshijnë në total një numër fëmijësh prej 3290 nga të cilët 20 (0.6%) janë romë dhe 174 egjiptianë (5%). Gjithashtu, ka një rritje të vogël përsa i përket klasave përgatitore në tre vitet e fundit, nga 409 klasa përgatitore në vitin 2014-2015 në 416 një vit më vonë në 437 në 2016-2017. Pavarësisht numrit në rritje të klasave përgatitore, asnjë fëmijë rom dhe egjiptian nuk rezulton të frekuentojë këto klasa.

Arsimi bazë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Vitet shkollore	Nxënës total	Rom	Egjiptian	Braktisës	Shansi i dytë
2014-2015	12,274	170	ska të dhëna	21	0
2015-2016	11,613	138	ska të dhëna	47	0
2016-2017	10,913	127	616	86	0

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, 2017

Arsimi i mesëm i lartë frekuentohet nga rreth 4450 nxënës, numër ky që është reduktuar nga njëri vit në tjetrin. Vetëm dy nxënës janë të komunitetit rom dhe 95 egjiptian. Pra, ka një frekuentim tepër të ulët të nxënësve nga dy


9. <http://www.avokatipopullit.gov.al/sq/content/20042016-fjala-e-ap-zigli-totozani-ne-seminarin-e-dialogut-politik-shqiperi-be-perfshirjen-e>, aksesuar me 16.01.2017

10. Ministria e Arsimit dhe Sportit, Gusht 2017,

komunitetet në arsimin e mesëm. Edhe pse shifrat bazohen në vetëdeklarime që jo gjithmonë bëhen. Të dhënat rreth arsimit bazë tregojnë për një ulje të lehtë në tre vitet e fundit të numrit total të nxënësve nga 12,274 në 2014-2015 në 10,913 nxënës në vitin më të fundit. Numri i nxënësve është reduktuar me 660 deri në 700 nxënës më pak në vitin më të fundit. I njëjti trend ka karakterizuar edhe numrin e nxënëve romë, i cili është reduktuar fillimisht me 32 nxënës e në vitin më të fundit me 11. Në lidhje me numrin e nxënësve egjiptianë, për dy vitet e para nuk ka të dhëna, ndërsa aktualisht e frekuentojnë arsimin bazë rreth 616 egjiptianë. Numri i nxënësve egjiptianë mund të jetë edhe më i lartë duke u nisur nga niveli i integritimit të tyre, dhe faktit që identifikimi i tyre bazohet kryesisht në vetëdeklarim.

Të dhënat në lidhje me numrin e nxënësve që braktisin shkollën tregojnë se aktualisht në vitin më të fundit (2016-2017) janë rreth 86 nxënës braktisës, numër ky pothuajse i dyfishuar për cdo vit shkollor që nga 2104. Ndërsa numri i nxënësve braktikës është rritur ndjeshëm, asnjë klasë e programit të shansit të dytë nuk ofrohet në shkollat e Beratit.

Grafiku 3. A ka braktisje të shkollës nga fëmijët e familjes/komunitetit tuaj?



Përkundër të dhënave më sipër, intervistat me persona kyç në sektorin e edukimit në Berat shprehen se fenomeni i braktisjes është reduktuar në shkollat e bashkisë, si edhe në lidhje me nxënësit nga këto komunitete, sidomos ata romë. Megjithatë, vetë pjesëtarët e dy komuniteteve konfirmojnë se ka braktisje nga fëmijët e komunitetit të tyre në masën 43%, ndërsa 45% e tyre e mohojnë braktisjen e shkollës.

Rastet më të shpeshta të braktisjes së shkollës ndodhin me fëmijët romë të zonës së ish-Pjeshkores, të cilët vijnë nga familjet në gjendje më të vështirë ekonomike dhe me probleme të shumta sociale.¹¹

Problemet e braktisjes, frekuentimit të ulët në të gjitha nivelet e arsimit, rezultateve të ulëta në mësim janë më të shpeshta te fëmijët e komunitetit Rom në dallim nga ata egjiptianë që paraqesin situatë më të përmirësuar në lidhje me arsimimin. Këto dallime konfirmohen edhe nga të dhënat e Censurit¹²ku 33.3% e të intervistuarve romë kanë deklaruar se nuk kanë shkuar asnjëherë në shkollë, përkundrajt 4.8% e egjiptianëve. Diferencë të konsiderueshme ka edhe frekuentimi i shkollës, ku rreth 43% e romëve të intervistuar kanë frekuentuar shkollën përkundrajt 88% të egjiptianëve. Edhe braktisja e shkollave përpara përfundimit të arsimit të detyrueshëm është fenomen shumë herë më i shpeshtë te romët, të cilët po sipas Censurit raportojnë rreth 24%, kurse egjiptianët vetëm 7%.

Faktor që mbështet frekuentimin e rregullt të shkollës nga fëmijët e dy komuniteteve është distanca e afërt e vendbanimeve të komuniteteve me godinat e shkollave dhe kopshteve. Ka një ndërgjegjësim në rritje të prindërve të komunitetit Rom dhe Egjiptian rreth rëndësisë së arsimit, gjë që faktikisht ende nuk mbështetet me rritjen e numrit të fëmijëve

11. Intervista me persona kyç (IDM, 2017)

12. OSFA, Censuri për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014

Profil: Shkolla “Shyqyri Lakra” është shkollë 9-vjeçare dhe ndodhet në Lagjen Donika Kastrioti, në të cilën jeton një komunitet i konsiderueshëm Rom dhe Egjiptian. Shkolla frekuentohet nga fëmijët e lagjes “Donika Kastrioti” si dhe nga fëmijët romë të lagjes Ish-pjeshkore. Në këtë shkollë ka patur një klasë të shansit të dytë, vetëm me fëmijë romë dhe egjiptianë, klasë që më vonë u integrua plotësisht. Më shumë se 50% e nxënësve që frekuentojnë shkollën janë fëmijë të komunitetit Rom dhe Egjiptian. Aktualisht, kjo shkollë frekuentohet nga 222 nxënës, nga të cilët 89 nxënës egjiptianë dhe 39 romë. Nga 39 nxënësit romë, 22 prej tyre janë vajza. Një nga klasat e shkollës ka në total 16 fëmijë, nga të cilët 12 janë romë.

Problem ende mbetet për nxënësit romë dhe egjiptianë mos përfundimi i sistemit; çdo vit, 3-5 fëmijë nuk përfundojnë vitin shkollor për shkak të lëvizjes së familjes. Sistemi i mungesave penalizon këta fëmijë për marrjen e certifikatës. Prindër të komunitetit Rom dhe Egjiptian janë anëtarë të bordit të prindërve. Kjo shkollë është e përfshirë në nismën e shkollave qendër komunitare dhe si e tillë, ka në vëmendje organizimin e aktiviteteve që promovojnë kulturën dhe traditat e dy komuniteteve.

që ndjekin shkollën. Gjithashtu, së fundi vetë komunitetet Rome kanë treguar të jenë iniciatorë të ndryshimeve pozitive në lidhje me arsimimin, siç është rasti i mbylljes së shkollës në fshatin Stan, në NJA Moravë. Shkolla në fshatin Stan frekuentohej vetëm nga fëmijë romë, për shkak se komuniteti afër shkollës është tërësisht romë. Si rrjedhim i këmbënguljes së vetë komunitetit shkolla u mbyll, dhe në dispozicion të fëmijëve do të vendoset një furgon për të mundësuar frekuentimin e shkollës më të afërt, që ndodhet rreth 2.5 km larg. Duket se kjo gjë tashmë është bërë realitet. Megjithatë, mundësia e transportit të fëmijëve duhet të jetë e përhershme për të garantuar frekuentimin e rregullt të shkollës nga fëmijët e këtij komuniteti.

Arsimi parashkollor përfaqëson fillesë shumë të rëndësishme për fëmijët e dy komuniteteve për faktin se hedh baza për arsimim të mirë dhe rrit gjasat që fëmijët të përfundojnë arsimin e detyrueshëm. Por edhe pse është kaq i rëndësishëm, ai mbetet ende sfidë për fëmijët e komunitetit rom, për faktin se ky nivel edukimi frekuentohet nga një numër shumë i kufizuar i fëmijëve të këtij komuniteti. Ndërsa, asnjë fëmijë rom nuk frekuenton kopshtin me drekë. Fëmijët e komunitetit Egjiptian e frekuentojnë arsimin parashkollor normalisht si fëmijët e pjesës tjetër të popullatës. Viteve të fundit është arritur të integrohen në arsimin parashkollor rreth 77 fëmijë romë dhe egjiptianë¹³. Megjithatë, të gjitha komunitetet ku ka popullsi rome dhe egjiptiane kanë infrastrukturë arsimore (kopësht dhe shkollë) gjë që krijon kushte të mira për frekuentimin e arsimit parashkollor dhe atij bazë.


Shkollat 9-vjeçare “XHemal Çekini”, “Thimi Tani” dhe “Shyqyri Lakra” mirëpresim një numër të konsiderueshëm nxënësish nga komuniteti Egjiptian. Shkolla 9-vjeçare ‘Shyqyri Lakra’ ka numrin më të lartë të fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian, për faktin se ndodhet në Lagjen “Donika

13. Intervistë me persona kyç (Përfaqësues të Drejtorisë Arsimore Rajonale, Berat, 2017)

Kastrioti” ku jeton një numër i konsiderueshëm romësh dhe egjiptianësh. Ndërkohë, kjo shkollë frekuentohet edhe nga fëmijët e komunitetit Rom dhe Egjiptian të lagjes Ish-Pjeshkore, edhe pse nuk përfaqëson shkollën më të afërt për t’u ndjekur nga këta të fundit. Aktualisht, nuk ka klasa të veçanta. Por, është evidente që duhet punuar ende për shkolla mikse (rasti i Shkollës “1 Maji”), që konkretisht do të thotë që fëmijët romë të zonës ish-Pjeshkore duhet të shkojnë në shkollën më të afërt të komunitetit të tyre, në këtë rast Shkollën “1 Maji”. Për të arritur këtë, është e rekomandueshme rajonalizimi i shkollave dhe kopshteve, me qëllim që fëmijët e një komuniteti/lagjeje të ndjekin shkollën/kopshtin më të afërt me komunitetin e tyre. Aplikimi i një rekomandimi të tillë pritet të kenë rezistencë, veçanërisht nga popullata mazhoritare.

Nga komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Berat, ai që paraqet problematikën më të madhe në lidhje me arsimimin, është komuniteti i ish-Pjeshkores. Ndërsa në fshatin Moravë, komuniteti është i organizuar dhe tregon nivele të larta integrimi në jetën sociale dhe ekonomike, duke pasur parasysh se këta banorë janë fermerë dhe përfitues të tokës sipas ligjit 1701.

Grafiku 4. Si e vlerësoni nivelin arsimor në komunitetin tuaj?



Për vetë faktin që zona e ish-Pjeshkores përfaqëson zonë të nxehtë në lidhje me probleme komplekse sociale dhe ekonomike, afër saj është ngritur dhe funksionon qendra komunitare. Roli i qendrës ka qenë tejet i rëndësishëm duke i ardhur në ndihmë komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, veçanërisht në fushën e edukimit. Stafi i qendrës bën fushata sensibilizimi “derë më derë”, veçanërisht gjatë muajit gusht, gjithashtu edhe Drejtoria Arsimore e Bashkisë Berat është pjesë e punës për sensibilizimin dhe gjithëpërfshirjen në kopshtin pranë qendres komunitare me qëllim eliminimin e segregimit të atij kopshti, përpara fillimit të sezonit të shkollor. Qendra është resurs për integrimin e komuniteteve dhe ka nevojë për më shumë promovim.

Pavarësisht, arsimimit të ulët të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane si dhe problemeve që shoqërojnë këtë fushë si rezultate të dobëta, frekuentimi i ulët, braktisja e shkollës etj, vetë pjesëtarët e këtij komuniteti kanë perceptim pozitiv mbi nivelin arsimor të komunitetit të tyre. Vetëm 9% e tyre e vlerësojnë shumë keq, dhe 6% keq, ndërsa 60% e vlerësojnë shumë mirë/mirë.¹⁴

Ndërsa në lidhje më infrastrukturuën fizike të godinave arsimore të intervistuarit vlerësojnë më mirë infrastrukturën e shkollave në krahasim me kopshtet. 24% e të intervistuarve vlerësojnë keq kopshtet, ndërsa veç 1% e tyre shkollat.¹⁵

Stafi mësimor në kopshte e shkolla është i rëndësishëm në krijimin e një ambienti mikpritës ku nxënësit e pakicave etnike apo edhe të shtresave vulnerabël të shoqërisë të ndjehen të mirëpritur. Përkushtimi i stafit mësimor është jetësor për progresin e fëmijëve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane. 61% e të intervistuarve vlerësojnë të mirë sjelljen e stafit mësimor në shkollën/kopshtin e komunitetit ndaj fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian, ndërsa 29% e tyre shumë të mirë dhe vetëm 10% mesatare.¹⁶ Ndër të tjera

14. IDM, Pyetsorë me komunitetin Rom dhe Egjiptian, 2017

15. Po aty

16. Po aty

ata shprehen se “mësueset kanë aftësi të afrojnë fëmijët; janë shumë të mira; janë të sjellshëm dhe të edukuar; janë të palodhur, na vijnë shpesh në shtëpi, kryejnë biseda me ne; nuk ka racizëm; qëndrojnë afër fëmijëve; kanë mënyrën e mirë për të mësuar fëmijët tanë; mësueset kanë sjellje pozitive në edukimin e fëmijëve.”

Vetë pjesëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian, 74% e të intervistuarve, mohon që qëndrimet diskriminuese të jenë faktor të braktisjes së shkollës nga fëmijët romë dhe egjiptianë; ndërsa 98% e tyre vlerësojnë ngacmimet në shkollë me aspak/pak si faktor të braktisjes së shkollës, 70% vlerësojnë rezultatet e ulëta në shkollë nga fëmijët romë dhe egjiptianë me aspak/pak si shkak për braktisje; 81% e tyre mohojnë se mund të jenë problemet me gjuhën shqipe faktor nxitës i braktisjes së shkollës dhe 68% vlerësojnë aspak/pak nevojën për të mbështetur prindërit për të fituar para për jetesën si një faktor për braktisjen e shkollës. Por, 89% e të intervistuarve vlerësojnë se pamundësia ekonomike për të ndjekur shkollën ndikon shumë/jashtëzakonisht shumë në braktisjen e shkollës.¹⁷

Dy probleme kryesore të artikuluar qartë në lidhje me mosfrekuentimin e shkollës nga fëmijët e komunitetit Rom është gjendja e vështirë ekonomike e familjeve romë, si dhe mungesa e edukimit prindëror e cila pengon transferimin e kulturës së edukimit tek fëmijët romë.¹⁸

Kalimi i funksionit të administrimit dhe rregullimit të sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe tek bashkia kërkon të vendoset dhe nxitet ndërveprimi ndërmjet aktorëve vendor si Bashkia, Drejtoria Arsimore, Drejtoria e Shëndetit Publik, si dhe strukturave komunitare, me qëllim evidentimin e fëmijëve të paregjistruar, të pavaksinuar dhe që nuk frekuentojnë arsimin parashkollor dhe bazë dhe marrjen e masave të duhura për secilin rast.

17. Po aty

18. Focus grup më banorë të komunitetit Rom në NJA Moravë

Kujdesi shëndetësor

Situata shëndetësore e pjesëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian dhe jetëgjatësia e tyre priret të jetë përgjithësisht më e ulët krahasuar me popullsinë në shumicë dhe se treguesit e gjendjes shëndetësore të romëve po përkeqësohen krahasuar me treguesit e shëndetit të popullsisë së përgjithshme të vendit¹⁹. Romët kanë një incidencë më të lartë sëmundshmërie dhe janë më të prekshëm sidomos ndaj sëmundjeve të transmetueshme²⁰.

Është e gjithëpranuar se qasja në shërbimet shëndetësore të komunitetit Rom dhe Egjiptian është e shoqëruar më një seri problemesh dhe sfidash. Varfëria, kushtet e vështira të jetesës, pamundësia për të paguar për shërbimet dhe mjekimet, diskriminimi i hapur ose i fshehur, traditat dhe kultura e romëve dhe egjiptianëve (martesat dhe lindjet e hershme), niveli i ulët arsimor, mungesa e informacionit dhe njohurive rreth shëndetit riprodhues, shtatzanisë, sëmundjeve infektive dhe seksualisht të transmetueshme, lindjeve dhe kujdesit për fëmijët, ndryshimet e shpeshta të vendbanimeve, punët me risk të madh shëndetësor, kequshqyerja, trajtimi jo të mirë nga ofruesit e kujdesit shëndetësor, mungesa e kapaciteteve të personelit mjekësor etj, përbëjnë shkaqet kryesore të qasjes së vështirë në shërbimet shëndetësore të komunitetit Rom dhe Egjiptian.


Megjithatë, intervistat²¹ e kryera tregojnë se pjesëtarët e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Beratit kanë perceptim pozitiv të gjendjes së tyre shëndetësore. Kështu, 41% e të intervistuarve shprehen se e vlerësojnë mirë gjendjen e tyre shëndetësore, ndërsa po kaq, 41%, shprehen mesatarisht; dhe 16% keq.

19. http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/draft_strategjia/Draft_Strategjia_30Maj2016_web.pdf, aksesuar me 19.06.2017

20. Po aty

21. IDM, Pyetorë me komunitetin Rom dhe Egjiptian, 2017

Grafiku 5. Si e vlerësoni gjendjen shëndetësore në komunitetin tuaj?



Numri i romëve dhe egjiptianëve të pajisur me karta shëndetësore në Bashkinë Berat është vështirë të identifikohet. Pavarësisht, pajisjes me kartë shëndeti, shërbimi shëndetësor parësor ofrohet falas si për ata që janë të pajisur me kartë shëndeti dhe për ata që nuk janë pajisur. Vendbanimet ku jetojnë romë dhe egjiptianët në Bashkinë e Beratit janë të mbuluar përgjithësisht mirë me shërbime bazë shëndetësore nga stafi shëndetësor i qendrave. Struktura e mediatorit shëndetësor ende nuk njihet dhe nuk funksionon në sektorin e shëndetit. Infermieret e qendrave shëndetësore shkojnë për vizita mjekësore në çdo shtëpi; për nënat dhe foshnjat ofrohen konsulta mjekësore si dhe ofrohen check-up falas. Vaksinimi bëhet i rregullt dhe ndiqet nga stafi mjekësor.²²

Pajisja me dokumente identifikues paraqitet problematike për dy komunitetet, në nivel më të përkeqësuar për pjesëtarët e komunitetit Rom. Dhe kjo nuk duhet kuptuar vetëm në lidhje me regjistrimin civil, por edhe në fusha të tjera si arsimi, punësimi, kujdesi shëndetësor, etj. Të dhënat zyrtare të ofruara nga FSDKSH tregojnë se pajisja me karta shëndeti


22. IDM, Intervista me persona kyç, 2017

paraqitet problematike, sidomos për romët. Raporti midis pjesëtarëve që kanë kartela shëndeti të hapura (dhe jo popullsisë totale) dhe pjesëtarëve të pajisur me karta shëndeti tregon se pjesa më e madhe e popullsisë së dy komuniteteve janë të papajisur me kartë shëndeti.

Qendrat shëndetësore	Egjiptianë		Romë	
	Me kartela shëndeti të hapura	Me kartë shëndeti	Me kartela shëndeti të hapura	Me kartë shëndeti
Qendra Shëndetësore Nr.1	3016	1538	37	15
Qendra Shëndetësore Nr.2	540	s'ka të dhëna	390	s'ka të dhëna
Qendra Shëndetësore Nr.3	1262	s'ka të dhëna	878	s'ka të dhëna
Qendra Shëndetësore Otllak	223	161	750	11

Burimi: Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Berat, 2017

Grafiku 6. A jeni pajisur me kartë shëndeti?




Megjithatë, 72% e të intervistuarve raportojnë se janë të pajisur me kartë shëndeti, përkundrajt 25% të cilët nuk janë pajisur me kartë shëndeti.²³

Vetë banorët shpjegojnë arsyet e mospajisjes me kartë shëndeti: *“nuk kemi patur mundësi për t’i marrë/nuk e shikoj shumë të nevojshme/nuk e kemi bërë, por do ta bëjmë/nuk jam interesuar/do e bëj së shpejti /nuk kemi të ardhura për ta bërë.”*

Duket qartë se pasiviteti, neglizhenca dhe mungesa e informacionit janë barrierat kryesore që një pjesë e madhe e tyre ende nuk janë të pajisur me kartë shëndeti.

Grafiku 7. Si e vlerësoni shërbimin shëndetësor në zonën tuaj?



Pavarësisht aksesit më të ulët në shërbimin bazë shëndetësor që karakterizon pjesëtarët e dy komuniteteve krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë, ata e vlerësojnë pozitivisht cilësinë e shërbimit mjekësor që ofrohet në zonën ku jetojnë. Siç shihet në grafik, më shumë se gjysma e të intervistuarve e vlerëson mirë (52%), ndërsa 14% shumë mirë.²⁴


23. IDM, Pyetorë me komunitetin Rom dhe Egjiptian, 2017

24. Po aty

Vetë banorët shprehen "s'e marrim shërbimin që na duhet/na vjen deri në shtëpi/nuk kujdesemi shumë për shëndetin/s'kemi lekë të vizitohemi dhe të marrim ilaçe/ ilaçet nuk rimburohen shumica e fëmijëve janë të pavaksinuar/ nuk më shohin me sy/ka diskriminim/doktoresha e lagjes na vjen deri në shtëpi."²⁵

Vlerësimi i sjelljes së stafit mjekësor nga banorët e dy komuniteteve rezulton më pozitiv se sa shërbimi shëndetësor që ata marrin. Rreth 58% të intervistuarve e vlerësojnë mirë sjelljen e stafit shëndetësor në lagjen e tyre, ndërsa 22% e tyre shumë mirë; 17% mesatarisht dhe vetëm 3% keq.

Grafiku 8. Si e vlerësoni sjelljen e stafit shëndetësor në lagjen tuaj?



Në përgjithësi, femrat e komunitetit Rom dhe Egjiptian karakterizohen nga lindshmëri të hershme dhe mungesë të thellë njohurie në metodat e planifikimit familjar, kujdesit të foshnjës dhe nënës. Dhe pse stafi i qendrave shëndetësore tregojnë se ndërmarrin fushata sensibilizimi në planifikimin familjar, kujdesin e foshnjës dhe nënës, ndërgjegjësimi duhet të jëtë më i

25. Po aty

lartë dhe programe edukimi duhet të ndërmerren për këtë.

Qendra komunitare pranë zonës së Ish-Pjeshkores përfaqëson një mundësi të mirë edhe për ofrimin e shërbimeve shëndetësore më pranë komuniteteve, duke rritur aksesin e tyre në shërbimin bazë shëndetësor. Për këtë, po bëhen përpjekje për të bërë të mundur lejimin e infermieres së qëndes shëndetësore më të afërt për të ofruar shërbim shëndetësor të paktën dy herë në javë.

Edhe pse pranë Fondit shëndetësor nuk është rregjistruar asnjë ankesë nga pjesëtarët e dy komuniteteve rreth pakënaqësive në shërbimin shëndetësor, pyetja ngrihet se sa njohuri kanë anëtarët e këtyre komuniteteve rreth mekanizmave ankimes në sektorin e kujdesit shëndetësor.


Punësimi, arsimit dhe formimi profesional (AFP)

Niveli i lartë i papunësisë, përfshirja masive në tregun informal të punës, të ardhura të paqëndrueshme, paqëndrueshmëri e lartë në vendin të punës, nivel i ulët kualifikimi, vështirësia për t'u përshtatur me orare të punës me kohë të plotë dhe me profile të ndryshme punësh, nivel i lartë i inaktivitetit, mosregjistrimi në zyrën e punës si të papunë, punëkërkues, mungesa e besimit te programet e punësimit, diskriminimi në vendin e punës, paraqesin kompleksitetin e problemeve që përjetojnë pjesëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian në tregun e punës. Si rezultat, pjesëtarët e dy komuniteteve kanë një shkallë më të lartë papunësie në raport me pjesën tjetër të popullatës. Në vitin 2016, niveli papunësisë së romëve dhe egjiptianëve në qytetin Beratit është përkatësisht 42.5% për komunitetin Rom dhe 48.9% për Egjiptianët²⁶.

26. Gëdeshi, I., Mykerezi, P. & Danaj, E. (2016). Hartëzimi i aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkitë e Tiranës, Durrësit, Beratit dhe Shkodrës. UNDP, Tirane

Hendeku gjinor për papunësinë për të dy komunitetet në Bashkinë e Beratit është i pranishëm, ku konkretisht për komunitetin Rom 47.2% e femrave janë të papuna në krahasim me 37.8% të meshkujve dhe për komunitetin Egjiptian rreth 53% e femrave janë të papuna krahasuar me 45.3% të meshkujve.²⁷ Pra, sikurse mund të shihet nga të dhënat, nga pikëpamja gjinore, niveli i papunësisë të femrat është më i lartë për të dy komunitetet, ku femrat egjiptiane kanë nivelin më të lartë të papunësisë. Ndërkohë që niveli i papunësisë së meshkujve egjiptianë është relativisht më i lartë se niveli i papunësisë së meshkujve romë.

Grafiku 9. Si e vlerësoni gjendjen e përgjithshme të punësimit për komunitetin tuaj?



Situatën e punësimit e vlerësojnë keq 74% e të intervistuarve romë dhe egjiptianë, ndërsa shumë keq 13% e tyre dhe po kaq, 13% mesatarisht.²⁸


Gjithashtu, 57.9% e romëve (50% meshkuj dhe 68.7% femra) dhe 86.4% e egjiptianëve (89.8 % meshkuj dhe 81.3% femra) janë të papunë në kërkim

27. Po aty

28. IDM, Pyetsorë me komunitetin Rom dhe Egjiptian, 2017

të punës²⁹. Treguesit për punëkërkesit egjiptianë për të dyja gjinitë janë shumë më të larta jo vetëm krahasuar me komunitetin Rom në Bashkinë e Beratit, por edhe në krahasim me të njëjtët tregues për dy komunitetet në qytetet e Shkodrës, Tiranës dhe Durrësit. Pra, komuniteti Egjiptian në qytetin e Beratit, veçanërisht femrat egjiptiane, janë masivisht (më shumë se 80%) në kërkim të një pune.³⁰

Grafiku 10. A janë të mjaftueshme të ardhurat nga punësimi juaj?



Përqindja e të punësuarëve që paguajnë sigurime shoqërore nga komuniteti Rom është 6.8% dhe për komunitetin Egjiptian 63%. Treguesi për komunitetin rom është tepër i ulët (ky tregues për meshkujt romë është 0%), që tregon se popullata rome në moshë pune, për shkak të papunësisë, apo punës në sektorin informal nuk paguan sigurime shoqërore, çka shkakton pasiguri për të ardhmen. Komuniteti Egjiptian, sidomos femrat (74.3%), në një përqindje të konsiderueshme paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore.³¹

29. Gëdeshi, I., Mykërezi, P. & Danaj, E. (2016). Hartëzimi i aftësive, mundësisë të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve rome dhe egjiptiane në Bashkitë e Tiranës, Durrësit, Beratit dhe Shkodrës. UNDP, Tiranë

30. Po aty

31. Po aty

Një prej sfidave kryesore në punësimin e dy komuniteteve ka të bëjë me punësimin afatshkurtër, dhe qëndrueshmëria në punë, si dhe sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme nga punësimi. 77% raporton se nuk ka një punë të vazhdueshme përkundrejt 28% që raporton se ka një punë të qëndrueshme.³²

Gjithashtu, siç shihet në grafik pjesa më e madhe e të intervistuarve, 63%, shprehen se të ardhurat që sigurojnë nuk janë të mjaftueshme, përkundrejt 24 % që pohojnë se të ardhurat janë të mjaftueshme dhe 13% të cilët janë të pasigurt.³³ Pjesëtarët e dy komuniteteve, të gjendur në mungesën e një punë të vazhdueshme, sigurojnë të ardhurat nëpërmjet punësimit në strukturat ekonomisë informale apo nëpërmjet vetëpunësimit kryesisht në aktivitete të tilla si: *“mbledhjen e hekurave, plastikës dhe kanaçeve; b) tregëtim të rrobave të përdorura; c) ku të dalë; d) me vështirësi me borxhe; e) me pension; f) me tokat, të mbjellat; g) emigracion; h) me të lypur; j) pastrim të shtëpive”*³⁴ Të gjitha alternativat e gjenerimit të të ardhurave të identifikuar nga vetë të intervistuarit, konfirmojnë paqëndrueshmërinë e burimeve të të ardhurave të familjeve të tyre, duke vështirësuar gjendjen ekonomike dhe bërë të pasigurt të ardhmen.

Ndonëse papunësia është e pranishme në të dy komunitetet në Bashkinë e Beratit burimet më të shpeshta të të ardhurave për të dyja mbeten pak a shumë të ngjashme; për komunitetin Rom burimet kryesore janë: të ardhurat nga vetëpunësimi (28.6%), ndihma ekonomike (21.4%) dhe nga puna me kohë të pjesshme (19.6%). Ndërkohë për komunitetin Egjiptian, janë pagat (36.4%); nga puna me kohë të pjesshme (15.5%) dhe ndihma ekonomike (11.8%).³⁵ Nga të dhënat më sipër, dy komunitetet në bashkinë e Beratit manifestojë karakteristika të ngjashme përsa i përket burimeve të të ardhurave që nuk i gjen në komunitetet Rome dhe Egjiptiane në bashki të tjera, si për shëmbull: a) ndërsa

32. IDM, Pyetsorë me komunitetin Rom dhe Egjiptian, 2017

33. IDM, Pyetsorë me komunitetin Rom dhe Egjiptian, 2017

34. IDM, Pyetsorë me komunitetin Rom dhe Egjiptian, 2017

35. Gëdeshi et al. (2016)

lypja përfaqëson burim alternativ të të ardhurave për dy komunitetet në bashkitë e mëdha të vendit, në Berat nuk identifikohet si burim të ardhurash; b) reminitancat nga emigracioni përfaqëson burim të konsiderueshëm të të ardhurave (7.1% romët; 8.2% egjiptianët); dhe c) pensioni përfaqëson burim të konsiderueshëm alternativ të të ardhurave, çka tregon që komuniteti Rom dhe Egjiptian paguajnë kontributet shoqërore.

Aktualisht, në zyrën e punës janë të regjistruar si të papunë rreth 450 persona, nga të cilët 118 janë anëtarë të komunitetit Rom dhe 370 të komunitetit Egjiptian.³⁶ Pavarësisht numrit tepër të lartë të anëtarëve të papunë nga komuniteti, asnjë prej tyre nuk është i regjistruar si punëkërkues. Në programin e nxitjes së punësimit për vitin 2017 janë 15 egjiptianë pjesëmarrës, dhe asnjë rom. Përfituesit e programit të nxitjes së punësimit punojnë në biznese kryesisht fashione (rrobaqepësi, canta letre, prodhim këpucë). Kurset e formimit që ndjekin janë formim nëpërmjet punësimit në rrobaqepësi, prodhim këpucësh dhe mobileri. Në Berat nuk ekziston asnjë qendër publike e formimit profesional e cila të ofrojë trajnime profesionale. Mungesa e një qendre të tillë bën që të rinjtë të mos përfitojnë nga programet të përshtatura për romët dhe egjiptianët që ofrohen falas, për të pasur një perspektivë më të mirë punësimi dhe cilësi jete të përmirësuar. Vetëm një numër i kufizuar individësh nga komuniteti Rom kanë marrë kurse të formimit profesional, si parukier, kamerier, kuzhinier etj., ofruar nga organizata të shoqërisë civile dhe të mbështetura nga donatorë të ndryshëm.

Dhe pse papunësia dhe përfshirja në sektorin informal të punës mbeten sfida kryesore të komunitetit Rom dhe Egjiptian, pjesa më e madhe e tyre, rreth 65%, përgjigjet që nuk janë regjistruar në zyrat e punës, përkundrajt 28% që raportojnë se janë rregjistruar.³⁷ Mosregjistrimi në zyrat e punës dhe mospajjsja

36. Drejtoria Rajonale e Punësimit, evidencat e muajit maj 2017

37. IDM, Pyetsorë me komunitetin Rom dhe Egjiptian, 2017



Punësimi i komunitetit Egjiptian dhe Rom në zonën e ish-Pjeshkores. Pjesa më e madhe e komuniteteve sigurojnë jetesën nëpërmjet punës informale, siç mund të shihet edhe nga karroca e kalit në këtë foto.

me kartën e papunësisëpërbën një barrierë që vështirëson aksesin ndaj shërbimeve sociale për familjet e këtyre komuniteteve, kryesisht ato me të ardhura të ulëta.

Foto 5: Oborr shtëpie në lagjen ish-Pjeshkore

Arsyet kryesore që vetë banorët e këtyre komuniteteve japin për mosregjistrim janë të shumta, dhe në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur më poshtë: *“sepse shumë veta kanë aplikuar dhe nuk kanë marrë asnjë përgjigje / nuk di si aplikohet / nuk kemi zanat, nuk jemi të aftë / nuk bëjmë dot punë tjetër / s’kemi moshë për punë / sepse ata kanë disa skema punësimi që me atë pagesë e kemi më mirë të punojmë kështu / sepse më çojnë tek çantat, këpucët dhe unë nuk punoj dot / jam regjistruar dhe nuk u bë asgjë / nuk kam profesion”*.³⁸

Bazuar në sa më sipër, mungesa e besimit se regjistrimi do u sjellë ndonjë ndryshim pozitiv, mungesa e informacionit, mungesa e kualifikimit, vështirësia për t’u përshtatur me llojet e punëve, pagesat e ulëta përkundrejt përfitimeve më të larta që sigurojnë në punët informale janë faktorët kryesorë të niveleve të ulëta të regjistrimit në zyra e punës. Specialistët e zyrës së punës raportojnë se, ndërsa nga njëra anë ka programe të nxitjes së punësimin dhe mundësira punësimi, nga ana tjetër nuk ka persona të interesuar që të aplikojnë për

38. IDM, Pyetorë me komunitetin Rom dhe Egjiptian, 2017

shkak të një sërë arsyesh: të menduarit dhe të jetuarit afatshkurtër; pagesa ditore e punëve informale është më e lartë se ajo e punësimit formal; të munguarit e kulturës së punës në lidhje me respektimin e kontratës dhe detyrimeve që rrjedhin nga ajo si orët e punës etj;

Edhe në çështjen e punësimit, aktorët vendor bëjnë dallimin ndërmjet dy komuniteteve për shkak se komuniteti Egjiptian është më pak i përfshirë në punësim në tregun informal, dhe nuk shfaqin problematika të përshtatjes me lloje të ndryshme pune siç ndodh rëndom me romët.

Strehimi dhe integrimi urban


Pjesëtarët e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane jetojnë në kushte të vështira jetese, në banesa me kushte jo të mira banimi, në sipërfaqe të vogla duke marrë parasysh jetesën në familje të gjëra me shumë anëtarë, në lagje ku shërbimet dhe infrastruktura publike është e dobët dhe shpesh ndodh edhe në zona informale. Sigurimi i kushteve të jetueshme të banimit mbetet një sfidë kryesore e pjesëtarëve të dy komuniteteve, krahas punësimit dhe sigurimit të të ardhurave për jetesë.

Programet sociale të strehimit që ofrohen nga qeverisja lokale, siç janë programi: a) i banesave sociale me qira; b) i banesave me kosto të ulët dhe c) i pajisjes së truallit me infrastrukturë, kirjojnë mundësi për strehim të përshtatshëm e të përballoeshëm. Megjithatë, më të varfërit e shoqërisë, siç janë edhe anëtarët e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, nuk përbëjnë përfituesit kryesor të këtyre programeve për shkak të kufizimeve që lidhen me konceptin e të ardhurave të pamjaftueshme për individët dhe familjet që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore. Duke u mbështetur në

aftësitë paguese të familjeve, programet sociale ulin aksesin dhe krijojnë përjashtimin e të varfërve. Studimet tregojnë se nga programet sociale të strehimit përjashtohen më të varfrit e të varfërve, të cilët nuk i plotësojnë kriteret për programet e strehimit social³⁹.

Kushtet e banimit: Banorët e dy komuniteteve të anketuar për vlerësimin e kushteve të banimit në të cilat jeton familja⁴⁰, pjesa më e madhe e tyre (45%) shprehen mesatarisht, 32% e tyre keq, 3% shumë keq, dhe vetëm 20% e tyre shprehen mirë.

Grafiku 11. Si i vlerësoni kushtet e banimit?



Në lidhje me banueshmërinë e godinës sipas censusit⁴¹ nga 220 familje të intervistuar vetëm një pjesë e vogël prej tyre (13.6%) deklarojnë godinën të banueshme, 27.3% pothuajse e pabanueshme, kur më shumë se gjysma e më të fundi të vlerësojnë banesën ku jetojnë pothuajse të pabanueshme, dhe vetëm 25% e deklarojnë godinën të pabanueshme.

Aksesi në programet e strehimit social: nga tre prej programeve sociale

39. Vendim i KM nr 405, datë 1.6.2016 Për Miratimin e Strategjisë së Strehimit Social 2016-2025

40. IDM, Pyetsorë me komunitetin Rom dhe Egjiptian, 2017

41. Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Census 2014-Banesat dhe Popullata Rome në Shqipëri

të strehimit Bashkia Berat ofron vetëm dy të parat: banesa sociale me qira dhe banesa me kosto të ulët.

Në **programin e banesave sociale** për vitin 2016 kanë aplikuar në total 80 familje, nga të cilat kanë përfituar 48 familje. Nga familjet përfituese, vetëm 2

5 prej tyre janë egjiptiane (31%), ndërsa asnjë familje rome nuk është përfituese e banesave sociale.⁴² Po sipas të dhënave zyrtare të bashkisë konfirmohet që katër familje rome kanë aplikuar dhe dy prej tyre kanë qenë përfituese të banesave sociale, por ato më vonë janë larguar nga banesa me dëshirë. Ndërsa, dy familjet e tjera rome kanë aplikuar për banesa sociale, por nuk kanë përmbushur kriteret.

Në programin e dytë të strehimit social, **banesë me kosto të ulët** për vitin 2016, kanë përfituar 35 familje nga 80 familje kërkuese. Asnjë familje rome nuk ka aplikuar për këtë program, ndërsa 20 familje egjiptiane kanë aplikuar dhe vetëm 9 prej tyre janë përfituese.


Për vitin 2016, në Bashkinë e Beratit ka patur 765 familje të cilat kanë aplikuar **në programin e ndihmës shtetërore si të pastrehë** dhe vetëm 12% e tyre (95 familje) kanë përfituar pagesë të qerasë dhe vetëm 1 grant për banesë me kosto të ulët. Ndër familjet përfituese janë edhe 6 familje egjiptiane, që përbëjnë 6%. Granti për banesë me kosto të ulët përfshin truallin, kontratë për energjinë elektrike, me ujësjellësin dhe sistemimin e fasadave të jashtme.

Të dhënat zyrtare tregojnë për nivele të ulëta aksesit të dy komuniteteve në këto programe, në një kohë që kushtet e banimit të tyre janë shumë të këqija dhe ekstremisht të vështira krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë.

42. Bashkia Berat, Drejtoria e Shërbimeve Sociale (2017)

Mungesa e informacionit rreth këtyre programeve është një nga faktorët që ndikon në aksesin e ulët të anëtarëve të dy komuniteteve në këto programe. 45% e banorëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian të intervistuar⁴³ shprehën që nuk e njohin programet sociale të strehimit, ndërsa 38% e tyre nuk ka aplikuar, dhe 10% e tyre nuk ka rezultuar përfitues pas aplikimit. Vetëm 7% e të intervistuarve shprehet se ka përfituar nga këto programe.

Grafiku 12. A keni përfituar ndonjëherë nga programet sociale të strehimit?




Ngjashëm si më sipër, kemi reagimet e qytetarëve në lidhje me ndihmën nga shteti si i pastrehë, ku nivele të përafërta raportimi tregojnë nëse kanë përfituar ndihmë nga shteti si i pastrehë. 41% e të intervistuarve nuk ka njohuri rreth skemës, ndërsa 47% nuk ka aplikuar ndonjëherë. Vetëm 10% e të intervistuarve raporton se ka aplikuar dhe 1% ka përfituar.

Anketimi i anëtarëve të dy komuniteteve në Bashkinë e Beratit tregon pse ata nuk kanë përfituar ndonjëherë ndihmë nga shteti si të pastrehë: *kam qenë në emigrim/më thanë në fillim të bëja disa dokumente dhe nuk më kthyen më përgjigje pasi i dorëzova ato/nuk di të aplikoj/nuk kemi mundësi ekonomike/nuk kam moshë dhe njohuri/nuk e përballojmë dot qeranë/nuk e di*

43. IDM, Pyetsorë me komunitetin Rom dhe Egjiptian, 2017

si funksionon kjo gjë/nuk plotësoja kriteret/nuk na e tha njeri këtë gjë...⁴⁴Duket qartë se veç mungesës së informacionit dhe njohurive se si aplikohet, edhe pamundësia e të ardhurave të mjaftueshme penalizon familjet rome dhe egjiptiane nga programet sociale të strehimit.

Grafiku 13. A keni përfituar ndonjëherë ndihmë nga shteti si i pastrehë?



Më poshtë po japim një pasqyrë të kushteve të strehimit dhe infrastrukturës lokale publike sipas lagjeve kryesore ku janë përqëndruar edhe dy komunitetet:

Lagja Donika: familjet e komunitetit Egjiptian dhe Rom jetojnë në banesa private, por në kushte banimi jo të mira, kryesisht të rrënuara, në kushte të këqija higjeno-sanitare. Ndërhyrja në KUZ është prioritare. Një pjesë e rrugës ku jeton komuniteti është në gjendje të vështirë teknike dhe kërkon ndërhyrje. Ky komunitet ndodhet afër qendrave kryesore ku ofrohen shërbime publike bazë si shkolla, kopshti, qendra shëndetësore dhe spitali i qytetit. Kjo vendodhje u krijon akses të lartë në shërbime publike bazë.

44. IDM, Pyetsorë me komunitetin Rom dhe Egjiptian, 2017



Privatizimi i banesave mbetet problem aktual për këtë komunitet dhe legalizimi i banesave është në proces.

Foto 6: Rrugë lagje në komunitet, "D.Kastrioti"

Lagja Barrikadë: familjet e dy komuniteteve të vendosura në këtë lagje jeton në kushte të vështira banimi, duke e kthyer këtë komunitet në një grup ideal për të përfituar nga programet sociale të strehimit. Por për shkak të të ardhurave të pamjaftueshme, nuk janë përfitues të programeve sociale të strehimit. Një nga problemet kryesore të këtij komuniteti është niveli i ulët i arsimimit.

Fshati Moravë: familjet e komunitetit vendor, kryesisht ata rom, jetojnë në banesa private të cilat janë banesa tipike fshati. Infrastruktura rrugore e fshatit është përgjithësisht e mirë. Furnizimi me ujë të pijshëm nuk është i mjaftueshëm dhe përbën një problem që kërkon vëmendje nga autoritetet publike. Gjatë vitit të fundit u bë e mundur mbyllja e shkollës në fshatin Stan, e cila frekuentohej kryesisht nga nxënës të komunitetit rom. Mbyllja e shkollës nuk mund të shihet si heqje e shërbimit publik arsimor, por si një aksion pozitiv për të shmangur segregimin. Nxënësit e këtij fshati frekutojnë shkollën e fshatit Moravë, dhe në këto kushte sigurimi i transportit nga Bashkia kërkohet të jetë i vazhdueshëm për të siguruar aksesin në shkollë.

Fakti që komunitetet Rome dhe Egjiptiane jetojnë në zona të ndryshme të qytetit, anëtarët e këtyre komuniteteve kanë akses njësoj si pjesa tjetër

e popullsisë, si për shembull furnizimi me ujë të pijshëm, infrastruktura rrugore, qendrat shëndetësore, shkollat, KUZ-të, ndriçimin publik etj. Nëse një shërbim publik është i kufizuar dhe joadekuat, kjo është për gjithë komunitetin vendor, dhe nuk lidhet me faktin e përkatësisë në një komunitet etnik apo grupi të vecantë.


Furnizimi me ujë të pijshëm në qytetin e Beratit ofrohet për të gjitha lagjet 16 orë në ditë. Kjo kohëzgjatje është edhe për familjet rome dhe egjiptiane. Ndërsa në Njësinë Administrative Otllak, furnizimi me ujë bëhet vetëm për 3 orë në ditë. Kjo kohëzgjatje është njësoj për gjithë komunitetin e banorëve të kësaj njësie. Në takimet me banorë të komunitetit Rom dhe Egjiptian në Moravë, pjesëmarrësit u shprehën se *“Nuk kemi ujë të pijshëm dhe tek Bregu i Sheqit nuk ka kanal kullues”*. Zona e Moravës është rurale, ku shërbimet publike kanë qenë më të mangëta krahasur me zonë urbane. Tashmë, Bashkia e Beratit duhet të ketë prioritet përmirësimin e shërbimeve publike edhe në zonat rurale për të siguruar kohezion social dhe ekonomik të territorit të vet.

Kanalizimet e ujrave të zeza shtrihen në gjithë territorin e bashkisë së Beratit duke përfshirë edhe zonat ku banojnë komunitete Rome dhe Egjiptiane. Problematike është zona e ish-Pjeshkores e cila është informale, ndaj edhe infrastruktura publike është e kufizuar. Ky problem është duke u zgjidhur me një financim për investim të ri nga PNUD

Infrastruktura rrugore në qytetin e Beratit në masë të konsiderueshme është e rregullt dhe e përmirësuar viteve të fundit. Ngjashëm si më sipër, përjashtim bën zona e ish-Pjeshkores për shkak të informalitetit. Por edhe në lagjen “Donika Kastrioti” një pjesë rruge në gjendje të keqe përbën problem për banorët e komunitetit Rom dhe Egjiptian. Vlerësimi i infrastrukturës publike nga anëtarët e dy komuniteteve tregon se 45% e të intervistuarve e vlerësojnë keq, ndërsa 33% e tyre mesatare, dhe 22% mirë. (IDM, 2107)

Lagja ish-Pjeshkorja: është zona më problematike në lidhje me strehimin dhe infrastrukturën publike. E gjithë zona e ish-Pjeshkores është zonë informale e ndërtuar me ndërtime të reja gjatë 20 viteve të fundit. Si rrjedhim, e gjithë zona ka probleme të infrastrukturës publike, ndërkohë që kohëve të fundit është zgjidhur problemi i ujit të pijshëm nëpërmjet një investimi publik të zbatuar nga bashkia në infrastrukturën e ujësjellësit. Legalizimi i ndërtimeve është në proces. Ndërkohë që kjo zonë është shumë e shtrirë duke pasur një numër të lartë të popullsisë, ku ndër të tjerë jetojnë edhe 40-50 familje rome të cilat kanë investuar në ndërtimin e banesave të reja. Problem janë 6 familje rome të cilat jetojnë në çadër. Këto familje janë të shqetësuar gjatë gjithë kohës nga pronarët e tokës, në të cilën kanë vendosur çadrat. Kjo bën që anëtarët e këtyre familjeve të jenë shumë pranë konflikteve. E gjithë zona është e riskuar nga përmbytja në rastet e shirave nga lumi Osum. Ndërtimi i argjinaturave të mbrojtjes lumore përbën prioritet për investimet e Bashkisë.

Grafiku 14. Gjendja e infrastrukturës në komunitetin tuaj



Në lidhje me vlerësimin e punës së bashkise për të adresuar problemet e strehimit dhe infrastrukturës publike që shqetësojnë komunitetin Rom dhe Egjiptian, anëtarët e këtyre komuniteteve shprehën: *"ka punuar, por do më shumë punë/nuk jam i kënaqur nga puna e Bashkisë/nuk kemi rrugë, kanalizime /nuk kanë vënë dorë për ne / rrugët janë të pashtuara, kanalizimet janë shumë keq, ndricimi shumë keq / nuk u treguan të sinqertë, ne kemi nevojë për ndihmë si shtëpia të riparohet edhe rrugët të shtrohen / nuk kanë bërë ndonjë gjë të madhe.⁴⁵"* Të gjitha këto tregojnë për nevojën e madhe për vëmendje dhe investime publike që kanë zonat ku janë të vendosur komunitetet Rome dhe Egjiptiane.

Më shumë sensibilizim rreth programeve sociale të strehimit, informacioni duhet të përshtatet dhe të jetë i kuptueshëm për këto komunitete. Ndërsa, sigurimi i kushteve minimale të jetesës nëpërmjet krijimit të mundësive të strehimit mbetet prioritet dhe jo vetëm do sjellë shëndet më të mirë

45. IDM, Pyetsorë me komunitetin Rom dhe Egjiptian, 2017

të anëtarëve të komunitit por do të ndikojë pozitivisht edhe në rritjen e frekuentimit të arsimit nga fëmijët e dy komuniteteve, sidomos atij Rom.

Mbrojtja sociale

Pjesëtarët dhe familjet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane përfaqësojnë ndër grupet vulnerabel të shoqërisë, nisur nga të ardhurat të përbashkëta dhe të paqëndrueshme. Studime kanë treguar se komuniteti Rom dhe Egjiptian është nga komunitetet me shkallën më të lartë të varfërisë (UNDP)⁴⁶. Për rrjedhojë ato përbëjnë grupet prioritare të programeve të mbrojtjes sociale – një nga mekanizmat kryesorë të zbutjes së varfërisë dhe përjashtimit social – që përfshijnë mirëqënien sociale, mbrojtjen e fëmijëve, shërbime komunitare për të adresuar dhe trajtuar nevojat në nivel komunitar. Megjithatë, pavarësisht kësaj, ende nuk mund të thuhet se anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian janë përfytyrë në nivele të kënaqshme të skemave të mbrojtjes sociale, kjo për shkak kryesisht të disa faktorëve të tillë si: mos plotësimi të dokumentacionit të kërkuar, apo edhe karakterit lëvizës të familjeve, informacioni i ulët rreth programeve, kuptueshmëri e ulët dhe vështirësia në plotësimin e dokumentacionit, pse jo dhe skemave me kritere jo shumë fleksibël për këto komunitete. Mungesa e regjistrimit për të përfituar ndihmë ekonomike i përjashton këto familje edhe nga shërbimet e tjera, përfshirë këtu kujdesin shëndetësor, strehimin social apo ndihmën ligjore falas.

Për vitin 2016, në **skemën e ndihmës ekonomike** (NE) janë përfshirë në total rreth 652 familje. Nga këto, 206 familje i përkasin komunitetit Rom dhe Egjiptian, pra rreth 32%. Përkatesisht, janë 46 familje rome (7%) dhe 160 egjiptiane (25%).⁴⁷ Numri i përfituesve të NE përputhet me numrin e familjeve që kanë kërkuar këtë ndihmë. Të 46 familjet rome përfituese të NE

46. UNDP, Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri

47. Të dhëna të marra nga Bashkia Berat, 2017.

janë banorë të qytetit Berat, ndërsa asnjë familje nga njësia administrative Otlak ku jeton një komunitet i konsiderueshëm Rom nuk është përfituese e skemës. Në skemën e NE nga kjo zonë rurale përfitojnë 24 familje, ku 2 familje janë egjiptiane. Marrë në konsideratë gjendjen e vështirë ekonomike të familjeve rome në këtë fshat, pritej që edhe numri i tyre të ishte i lartë. Pamundësia për të siguruar dokumentin e çertifikatës së pronësisë - dokumenti kryesor për të aplikuar në skemën e NE për familjet në zonat rurale që kanë në pronësi tokë bujqësore - përjashton familjet rome nga skema e NE. Problemet e titujve të pronësisë, tokat e gërryera nga erozioni dhe mospërputhshmëria me hartat topografike janë disa nga shkaqet që kufizojnë familjet për t'u pajisur me çertifikatën e pronësisë.⁴⁸ Përgjithësisht, njohuritë e pakta rreth programeve, moskuptueshmëria e procedurave, mungesa e dokumentacionit, lëvizjet e shpeshta të familjeve rome janë disa nga arsyet kryesore të aksesit të ulët të familjeve të dy komuniteteve, kryesisht atij Rom, në skemën e NE

Pagesa e aftësisë së kufizuar (PAK) - një skemë tjetër pagese e mbrojtjes sociale – ofron pagesë për aftësinë e kufizuar e cila në Bashkinë e Beratit lidhet me kryesisht me verbërinë, para dhe tetraplegjik. Për vitin 2016, përfituesit e kësaj skeme sipas njësive administrative dhe komuniteteve Rome dhe Egjiptiane jepet në tabelën më poshtë.

Nr.	Njësiti administrative	Nr. Përfitues total	Nr. Përfitues rome	Nr. Përfitues egjiptiane
	Bashkia Berat	946	50	264
	Otlak	190	26	3
	Sinje	107	0	0
	Roshnik	90	0	0
	Velabisht	182	0	3


Burimi: Bashkia Berat, 2017

48. Analia SëOT me grupin lokal të zhvillimit të komunitetit rome dhe egjiptian, Berat, maj 2017

Në një total prej 1,515 përfituesish të pagesës së aftësisë së kufizuar, 76 prej tyre janë romë (5%) dhe 270 egjiptianë me 17%. Në fakt, numri i përfituesve egjiptianë mund të jetë edhe më i madh, por nuk ka të dhëna të sakta, për faktin se komuniteti Egjiptian refuzon të identifikohet si komunitet në nevojë për shkak të nivelit të lartë të integritimit në jetën shoqërore.

